

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit dhe Turizmit Shqiptar (AATSF)

Kriteret e pranueshmërisë për nën-huamarrësit të angazhuar në Bujqësi

1. Përfituesit e Kualifikuar

Fermerët dhe kompanitë në sektorin e agrobiznesit, të kategorizuar në nën-sektorët e mëposhtëm:

- Bujqësia Primare përfshirë:
 - Blegtori¹,
 - bujqësia e të mbjellave,
 - fara, plehra dhe rritja e bimëve,
 - vaj, perime dhe frutorë.
- Pajisjet Bujqësore, Logjistika dhe Ofruesit e Shërbimeve përfshirë:
 - furnizuesit e makinerive dhe pajisjeve bujqësore,
 - Furnizuesit e kabanoneve dhe magazinimeve frioriferike/pajisjeve.
- Agropërpunuesit, përfshirë:
 - furra buke dhe pastiçeri,
 - thertore dhe përpunimi i mishit²,
 - prodhuesit e vezëve dhe të qumështit,
 - prodhuesit e vajit,
 - prodhuesit e ushqimeve të paketuara,
 - ujë, pije joalkoolike, birra dhe prodhues të verës, etj.
- Tregtarët Agro me shumicë dhe pakicë duke përfshirë:
 - tregtarët me shumicë të mallrave- agro dhe ushqimeve,
 - shitësit me pakicë të ushqimeve.

2. Raportet kryesore financiare të klientëve të kualifikuar:

Miratimet e kredisë duhet të respektojnë disa marrëveshje financiare për secilin klient sipas nënsektorit në lidhje me raportin e mbulimit të borxhit, raportin e ripagimit të borxhit dhe raporte të kapitalit.

3. Kreditë e kualifikuara

- Përdorimi i të ardhurave: Kredi për kapital qarkullues ose shpenzime kapitale në cilindo prej sektorëve të kualifikuar të agrobiznesit të renditura më sipër.
- Përjashtimet e zbatueshme: Lista e përjashtimeve të Sektorit të BERZH-it, Lista e Përjashtimeve Mjedisore dhe Sociale, si dhe lista e BERZH-it për personat, apo entitetet e papërshtatshme për të marrë financim.
- Kredi që nuk kanë përfituar dhe nuk do të përfitojnë nga skema të tjera të ndarjes së riskut, apo garancive të dhëna nga palë të treta përveç BERZH.

¹ Në varësi të pajtueshmërisë me standardet (BE) për mirëqenien e kafshëve.

4. Afati maksimal i kredisë

- Afati maksimal i kredive për kapitalin punues sezonal - deri në [3] vjet me rinovimin vjetor.
- Afati maksimal për të gjitha huatë e tjera - deri në [5] vjet.
- Kreditë duhet të amortizohen me jo më shumë se [35]% të shumës së kredisë për transh.

5. Shuma maksimale e kredisë

- Shuma e kredisë për klientë nuk duhet të tejkalojë:
 - EUR 500,000/EUR 600,000 për kreditë në bujqësinë primare,
 - EUR 1,000,000/EUR 1,500,000/ për tipe të tjera të kredive të agrobiznesit,
- Angazhimi maksimal për të njëjtin klient EUR 1,500,000/ EUR 2,000,000/EUR 2,500,000.





6. Sigurimi i mbulimit të kredisë

- Për kreditë me një afat deri në 36 muaj - nuk kërkohet asnjë mbulim minimal,
- Për kreditë me një afat mbi 36 muaj - sigurimi i përgjithshëm i zbatueshëm për marrëveshjen përkatëse të nën-kredisë duhet të jetë ekuivalente me të paktën 50% të zotimit sipas marrëveshjes përkatëse të nën-kredisë.

7. Kushte të tjera

- Skema e AASF mund të kombinohet në mënyrë të përsosur me skemat IPARD.
- Institucionet Financiare kanë procedurat e tyre për të aprovuar ose refuzuar kreditë.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni Institucionet tona Financiare Partnere.

<p>Adela Sheshi </p> <p>Project Finance Specialist Corporate & SE Products Division Blvd Bajram Curri Etc Tirana, Albania Tel: +355 4 2381000-2652 ADELA.SHESHI@raiffeisen.al www.raiffeisen.al</p>	<p>Elena Balliu </p> <p>Head of Small Business Department Retail Division Rr. "Ismail Qemali" No.27, Tirana, Albania Tel.:+355 4 2 276 210/68 9037147 elena.balliu@intesasnpaolobank.al www.intesasnpaolobank.al</p>
<p>Gramos Lipovica </p> <p>Branch Manager Rr. "Dritan Hoxha", Nd.92, H.15, Tirane Tel: +355 (4) 2 389 389 Gramos.Lipovica@procredit-group.com https://www.procreditbank.com.al/</p>	<p>Iris Memishahi </p> <p>Professionals and VSB Department Manager Twin Towers, Bul. "Dëshmorët e Kombit" Kulla 1, Kati 9, Tirana, Albania Tel: +355 68 40 12 121/69 40 12 121 Iris.Memishahi@otpbank.al http://www.otpbank.al/</p>